



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Ligjit për Zyrtarët Publik Nr NR. 08/L-197, nenit 4 të Rregullores (QRK) - Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijushmërinë e Zyrtarëve Publik si dhe neneve 40 dhe 41 dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr:

VENDIM

PËR ZGJATJEN E ORARIT TË PUNËS PËR SEKTORIN E GJENDJES CIVILE

Neni 1

1. Me këtë Vendim përcaktohet zgjatja e orarit të punës për Sektorin e gjendjes Civile i cili funksionon në kuadër të Drejtoratit për Administratë në Komunën e Lipjanit.
2. Sektori i Gjendjes Civile për periodën prej datës 29.07.2026 e deri me datën 30.08.2026, do të punojë çdo ditë pune me palë nga ora 08:00 deri 16:00, duke përfshirë edhe kohën e pauzës prej orës 12:00 deri në 13:00 ku do të punohet me rotacion.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Administratë.

Arsyetim

Zgjatja e orarit të punës bëhet për shkak të numrit të madh të kërkesave që parashtrohen në këtë Sektor që ndërlidhet me fluksin e ardhjes së mërgimtarëve nga shtetet e ndryshme të botës të cilët e kanë të nevojshme rregullimin e dokumentacionit personal.

Nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
Drejtoratit për Administratë
Sektorit të Gjendjes Civile
Sektorit për Personel

1Nr. 130/05-35926
Lipjan, më 29.07.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR ZËVENDËSIMIN E ZYRTARES MONITORUESE TË ZONËS EKONOMIKE – PARKUT INDUSTRIAL NË QYLAGË

I. Me këtë Vendim, zëvendësohet, zyrtarja monitoruese e Zonës Ekonomike - Parku Industrial në Qylagë në numrin rendor dy (2) Fitore Buja nga Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim e caktuar, sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës për caktimin e zyrtareve monitoruese të Zonës Ekonomike - Parku Industrial në Qylagë 1Nr.020/01-2391 i datës 11.01.2024, për shkak të transferimit në Institucionin tjetër dhe në vend të saj caktohet:

ABEDIN BAJRAMI, nga Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtareve monitoruese të Zonës Ekonomike - Parku Industrial në Qylagë janë të përcaktuara me dispozitat e Vendimit të Kryetarit të Komunës për caktimin e zyrtareve monitoruese të Zonës Ekonomike - Parku Industrial në Qylagë 1Nr.020/01-2391 i datës 11.01.2024.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

Abedin Bajramit

Valon Pacolli, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim

Gafurr Hetemi, Zyrtar monitorues i Zonës Ekonomike "Parku Industrial" në Qylagë

1Nr. 020/01-2391/2

Lipjan, 27.07.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Rregullores (QRK)- NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, udhëzuesit për zbatimin e Rregullores, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT KOMUNAL

I. Me këtë Vendim, zëvendësohet, anëtari i Komisionit komunal për monitorimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në numrin rendor katër (4) Linda Shahini nga Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim e caktuar, sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës për themelimin e Komisionit komunal për monitorimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale 1Nr.020/04-15413 i datës 02.04.2026, në vend të saj caktohet:

ABEDIN BAJRAMI, nga Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit komunal për monitorimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale janë të përcaktuara me dispozitat e Vendimit të Kryetarit të Komunës për themelimin e Komisionit komunal për për monitorimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale 1Nr.020/04-15413 i datës 02.04.2026.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

Hazbi Ademit, Zyra e Kryetarit-Sektori për çështje pronësore-juridike, Kyesues i Komisionit, Abedin Bajramit

1Nr. 020/04-15413/2
Lipjan, 22.07.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR
SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **10,360.00€**, (dhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-29514 e datës 01.07.2026, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 37 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin qershor të vitit 2026 me nga 280 euro për secilin rast $37 \times 280 = 10,360.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-29514
Lipjan, më 02.07.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L- 040- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 të datës 4 qershor 2008, si dhe të nenve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr këtë :

V E N D I M
(për korrije - shirjet 2026)

Neni 1

Obligohet, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, që të organizojë procesin e fushatës së korrije-shirjeve për vitin 2026 në territorin e Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, formon komisionin profesional për monitorimin e procesit të korrije-shirjeve për vitin 2026 në territorin e Komunës së Lipjanit.

Neni 3

Autokombajnerët duhet të jenë të pajisur me mjetet e nevojshme gjatë procesit të korrije-shirjeve si mjete kundër zjarrit, rezervuar me ujë, lopatën, kazmën, rërën etj.

Neni 4

Autokombajnerët obligohen që të respektojnë rendin e korrije-shirjeve, autokombajnat duhet të jenë në gjendje të mirë teknike, të mos ketë rrjedhje të drithërave më tepër se 5%.

Neni 5

Autokombajnerët udhëzohen që të respektojnë Rekomandimin e MBPZHR, për lartësinë e çmimit të korrije-shirjes prej 140 € për një hektarë.

Neni 6

Pas përfundimit të fushatës së korrije-shirjeve, Komisioni për monitorimin e procesit të korrije-shirjeve harton raportin e punës lidhur me mbarëvajtjen e procedurës së korrije-shirjeve për vitin 2026.

Neni 7

Për moszbatimin e dispozitave të këtij vendimi do të ndëshkohet pronari i autokombanjes në shumë prej 150 €.

Neni 8

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorat për Bujqësi dhe Pylltari si dhe Drejtorati për Inspeksion.

Neni 9

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe me këtë Vendim do të njoftohet Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari si dhe Drejtorati për Inspeksion.

1Nr. 320/01-29952
Lipjan, më 03.07.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve –, që kanë aplikuar sipas thirrjes publike "Rinia Fest –Lipjan 2026" në Komunen e Lipjanit" Nr.05-453/01-31961 të datës 13.07.2026, në përbërje si vijon:

1. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Saranda Krasniqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Haris Ahmeti nga OJQ-të anëtar
5. Viola Hetemi, në cilësinë e ekspertës të jashtme, anëtare
6. Albulena Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtarë rezervë

**Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kanë aplikuar sipas thirrjes publike "Rinia Fest-Lipjan 2026 në Komunen e Lipjanit" Nr.05-453/01-31961 të datës 13.07.2026, të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Komisioni do t'i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-34132
Lipjan, më 22.07.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 78 të Ligjit të punës Nr. 03/L-212, nenit 33 të Rregullores (QRK) Nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo – arsimore dhe aftësuese (IEAA) të paaruniversitar si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës nxjerr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Neni 1

Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të aplikantëve për procesin e konkursit publik për titullin e vendit të punës: Drejtor i Institucionit Edukativo Arsimor IEAA-AP të shpallur nga Drejtorati për Arsim i Komunës së Lipjanit me Nr.01.111/01-23514 të datës 25.05.2026, në këtë përbërje:

1. Drita Islami, Drejtoreshë në SHFMU , Kryesuese
2. Liridon Duhlaku, zyrtar ligjor – DKA, anëtar
3. Rizvan Hoxha, zyrtar lartë për personel , anëtar

Neni 2

Detyrë e Komisionit të ankesave është shqyrtimi i ankesave për procesin e konkursit publik për titullin e vendit të punës: Drejtor i Institucionit Edukativo Arsimor IEAA-AP të shpallur nga Drejtorati për Arsim i Komunës së Lipjanit Nr.01.111/01-23514 i datës 25.05.2026 si dhe ka mandat të përkohshëm .

Komisioni ka për detyrë që ankesat ti shqyrtojë dhe të vendosë brenda afatit 15 ditor nga dita e pranimit .

Punët e pranimit të ankesave dhe punët tjera administrativo-juridike për Komisionin do ti kryej Drejtorati për Arsim.

Neni 3

Me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Drejtorati për Arsim , Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi menjëherë .

1Nr. 020/04-36117
Lipjan, më 30.07.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

